

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alineja 9 dhe nenit 20 paragrafi 1 alineja 3 nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 и 27/19), në lidhje me nenet nga 137 deri 147 nga Ligji për marrëdhënie pune („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16dhe120/18), në përpuethshmëri me nenin 27 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive për sektorin publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr 10/08 dhe 85/09) dhe Konkluzioni i Këshillit të Ligjit nr.02-4519/5 nga 17.10.2018, miratuar në seancën e 42-të të mbajtur më 17.10.2018, u përgatit një Tekst i pastruar i Rregullores për përcaktimin e kohëzgjatjes së pushimit vjetor për punonjësit e shërbimit profesional të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Teksti i pastruar i Rregullores për përcaktimin e kohëzgjatjes së pushimit vjetor i punonjësve në Shërbimin profesional të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, i përfshin: rregulloren për kohëzgjatjen për pushimin vjetor të punonjësve në Shërbimin profesional të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.01-1879/1 nga 12.03.2015, Rregullore nr.01-1879/2 nga 31.03.2015, për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për përcaktimin e kohëzgjatjes së pushimit vjetor të punonjësve në Shërbimin profesional të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.01-1879/1 nga 12.03.2015 dhe Rregulloren nr.01-4549/1 nga 17.10.2018, për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për përcaktimin e kohëzgjatjes së pushimit vjetor për punonjësit në Shërbimin profesional të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.01-1879/1 nga 12.03.2015 dhe nr.01-1879/2 nga 31.03.2015.

**RREGULLORE
PËR PËRCAKTIMIN E KOHËZGJATJES SË PUSHIMIT VJETOR TË
PUNONJËSVE NË SHËRBIMIN PROFESIONAL TË AGJENCISË PËR SHËRBIME
MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIVIZUELE
(Tekst i pastruar)**

1. Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Kjo rregullore përcakton kohëzgjatjen (gjatësinë) e pushimit vjetor, mënyrën e fitimit të së drejtës për pushim vjetor dhe kushtet për shfrytëzimin e pushimit vjetor, nga stafi për shërbim profesional të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Neni 2

Punonjësi ka të drejtë në pushim vjetor me pagesë gjatë një viti kalendarik që zgjat të paktën 20 (njëzet), dhe më së shumti 26 (njëzet e gjashtë) ditë pune.

Kohëzgjatja e pushimit vjetor të punonjësit përcaktohet në bazë të:

- koha e kaluar në punë dhe
- ndërlíkimi në vendin e punës.

Punëtor më i vjetër (grua mbi 57 vjeç dhe burrë me 59 vjet), invalid, punëtor me aftësi të kufizuar me të paktën 60% paaftësi fizike dhe punëtor që kujdeset për një fëmijë me shëndet fizik ose mendor të kufizuar ka të drejtë edhe 3 (tre) ditë pune pushim vjetor.

Neni 3

Punëdhënësi është i detyruar ti lëshojë një vendim punëmarrësit për të drejtën e shfrytëzimit të pushimit vjetor.

Neni 4

Pushimet, të shtunat dhe të dielat dhe ditët e pushimit, mungesat për shkak të sëmundjes, si dhe raste të tjera të mungesës së justifikuar nga puna nuk llogariten në ditët e pushimit vjetor.

Neni 5

Punonjësi ka të drejtë në kompesimin për pjesën e papërdorur të lejes para përfundimit të marrëdhënies së punës, nëse paraprakisht ka kërkuar shfrytëzimin e pushimit vjetor, dhe nuk iu lejua marrëdhënia e punës i ndërprite pa dëshirën e tij.

Neni 6

Pas përfundimit të punësimit, punëdhënësi është i detyruar që ti japë punonjësit një vërtetim për pushimin vjetor të shfrytëzuar.

Neni 7

Çdo marrëveshje me punonjësin është e pavlefshme për heqjen dorë nga e drejta e pushimit vjetor.

2. FITIMI I TË DREJTËS PËR PUSHIM VJETOR

Neni 8

Punonjësi, i cili për herë të parë krijon një marrëdhënie pune, fiton të drejtën për pushim të plotë vjetor, kur ai arrin punë të pandërprerë jo më pak se gjashtë muaj me të njëjtin punëdhënësi, pavarësisht nëse punonjësi punon me kohë të plotë ose të shkurtuar nga koha e plotë.

Neni 9

Punonjësi ka të drejtë të përdorë një pjesë proporcionale të pushimit vjetor në shumë totale prej 2 (dy) ditësh për secilin muaj të punës, nëse:

- 1) nëse në vitin kalendarik në të cilën ai ka filluar punë nuk janë fituar të drejtat për pushim të plotë vjetor;
- 2) punësimi i tij ishte ndërprerë para skadimit të mandatit, pas skadimit të së cilit ai do të kishte të drejtë në pushim të plotë vjetor.

3. PËRCAKTIMI I KOHËZGJATJES SË PUSHIMIT VJETOR

Neni 10

Kohëzgjatja e pushimit vjetor të punonjësve në Shërbimin profesional të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, përcaktohet, në bazë të kriterëve të përcaktuara në nenin 2 paragrafi 2 të Rregullores.

Për secilin nga kriteret e renditura në nenin 2 paragrafi 2 i rregullores, përfitohen një numër i caktuar të ditëve të punës, të cilat shtohen në minimum 20 ditë, si më poshtë:

a) bazuar në kohën e kaluar në punësim:

- deri në 5 vjet
- deri në 10 vjet

2ditë pune;
3 ditë pune;

-deri në 15vjet
-deri në 20 vjet
- deri në 25vjet

4ditë pune;
5 ditë pune;
6 ditë pune.

dhe

6) bazuar në vështirësin e punës në vendin e punës :

- drejtori i Agjencisë, zëvendës drejtori i Agjencisë, udhëheqës sektori, shef shërbimi, ndihmës udhëheqës sektori, udhëheqës departamenti dhe bashkëpunëtor i lartë
1 ditë pune.

4. SHFRYTËZIMI I PUSHIMIT VJETOR

Neni 11

Pushimet përdoren duke marrë parasysh nevojat në vendin e punës, si dhe dhënien e mundësisë së punonjësit për pushim dhe relaksim duke marrë parasysh përgjegjësitë e tij familjare .

Punonjësi ka të drejtë të përdorë dy ditë nga pushimi vjetor ti shfrytëzojë në ditë që ai vetë do ti përcaktojë, nëse nuk e rrezikon seriozisht procesin e punës, i cili duhet ta raportojë Drejtorin e Agjencisë, përmes njoftimi i paraqitur eprorit të tij të menjëhershëm/udhëheqës sektori, shef departamenti, shef shërbimi, jo më vonë se tre ditë para përdorimit.

Neni 12

Pushimi vjetor zakonisht përdoret gjatë një viti kalendarik.

Pushimet mund të shfrytëzohen në disa pjesë në marrëveshje me punëdhënësin, dhe kjo pjesë e pushimit vjetor duhet të zgjasë së paku dy javë pune të pandërprara.

Punëdhënësi është i detyruar ti sigurojë punëmarrësit shfrytëzim të dy javëve të punës së pandërprerë të pushimit vjetor deri në fund të vitit të vjetër kalendarik, dhe pjesa tjetër më së voni deri më 30 qershor.

Pushimet që nuk janë përdorur në vitin kalendarik aktual për shkak të sëmundjeve ose dëmtimi, pushim lindjeje ose pushim për kujdesjen dhe ruajtjen e fëmijës, punonjësi ka të drejtë ta përdorë atë deri në 30 qershor të vitit të ardhshëm kalendarik.

Neni 13

Pushimi vjetor i punonjësve në shërbimin profesional të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, për secilin vit aktual, përcaktohet në nivelin e shërbimit profesional të Agjencisë në tërësi deri në fund të muajit kalendarik bazuar në planet e paraqitura për përdorimin e pushimit vjetor, të vërtetuar nga punonjësi në shërbimin profesional të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, më së voni deri në maj të vitit të kaluar, bazuar në planet e paraqitura për përdorim të pushimit vjetor nga drejtuesit e njësive organizative në shërbimin profesional të Agjencisë.

Plani i përdorimit të pushimit vjetor të punonjësve të shërbimit profesional të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, për secilin vit aktual, miratohet nga Drejtori i Agjencisë.

Shfrytëzimi i pushimit vjetor me kërkesë të punonjësit, aprovohet nga shefi i departamentit dhe konfirmohet nga drejtori i Agjencisë, duke lëshuar një vendim për të drejtën për të shfrytëzuar pushim vjetor.

Vendim për të drejtën e përdorimit të pushimit vjetor nga ana e drejtorit të Agjencisë, nënshkruhet nga Zëvendës Drejtori i Agjencisë. Në kushtet kur nëndrejtori i Agjencisë, vendimin për të drejtën e përdorimit të pushimit vjetor nuk

mund ta ketë pasi ende nuk është zgjedhur, atëherë këtë të drejtë e ka Kryetari i këshillit të Agjencisë.

Vendimin për të drejtën e përdorimit të pushimit vjetor të Zëvendës Drejtorit të Agjencisë e nënshkruan drejtori i Agjencisë, dhe në kushte të mungesës ose pengimit të tij, vendimin për të drejtën e përdorimit për leje vjetore të Zëvendës Drejtorit të Agjencisë, e nënshkruan Kryetari i Këshillit të Agjencisë.

5. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 14

(Neni 11 paragrafi 2 i Rregullores për përcaktimin e kohëzgjatjes së pushimit vjetor të punonjësve në shërbimin profesional të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.01-1879/1 nga 12.03.2015)

Punonjësi ka të drejtë të përdorë një ditë nga pushim vjetor që do ta përcaktojë vetë, nëse nuk e rrezikon seriozisht procesin e punës i cili duhet ti raportojë Drejtorit të Agjencisë, përmes njoftimit të paraqitur tek udhëheqësi i sektorit, ose udhëheqësi i departamentit, jo më vonë se tre ditë nga dita e fillimit të pushimit.

Neni 15

(neni 12 paragrafi 2 i Rregullores për ndarjen e pushimit vjetor ndërmjet të punësuarve të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.01-1879/1 nga 12.03.2015)

Pushimet mund të përdoren në dy pjesë, pjesa e parë duhet të zgjasë të paktën 12 ditë pune.

Neni 16

(Neni 14 i **Rregullores** për përcaktimin e kohëzgjatjes së pushimit vjetor punonjësve në shërbimin profesional të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.01-1879/1 nga 12.03.2015)

Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje pushon së funksionuari Rregullorja për përcaktimin e vazhdueshmërisë së pushimit vjetor e të punësuarve në Shërbimin Profesional të Këshillit për radiodifuzion nr.01-2894/1 nga 22.07.2009.

Neni 17

(neni 3 i Rregullores për ndryshimin e Rregullores për përcaktimin kohëzgjatjen e pushimit vjetor të punonjësve në shërbimin profesional të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.01-1879/2 nga 31.03.2015)

Të gjitha dispozitat e tjera të Rregullores për përcaktimin e kohëzgjatjes të pushimit vjetor të punonjësve në shërbimin profesional të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.01-1879/1 nga 12.03.2015, mbeten të pandryshuara.

Neni 18

(neni 15 i Rregullores së procedurës për përcaktimin e kohëzgjatjes së pushimeve vjetore të punonjësve në shërbimin profesional të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.01-1879/1 nga 12.03.2015)

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj, dhe do të postohet në tabelën e shpalljeve të Agjencisë të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Neni 19

(neni 4 i Rregullores për ndryshimin e Rregullores për përcaktimin kohëzgjatjen e pushimit vjetor të punonjësve në shërbimin profesional të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr 01-1879279/2 nga 31.03.2015)

Kjo Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për përcaktimin e kohëzgjatjes së pushimit vjetor të punonjësve në shërbimin profesional të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.01-1879/1 nga 12.03.2015 hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj, dhe do të postohet në tabelën e shpalljeve të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Neni 20

(neni 8 i Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për përcaktimin e kohëzgjatjes të punonjësve në shërbimin profesional të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr . 01-4549/1 nga 17.10.2018)

Kjo rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për përcaktimin e kohëzgjatjes së pushimit vjetor të punonjësve në shërbimin profesional të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.01-1879/1 nga 12.03.2015, me ndryshime dhe plotësime nr.01-1879/2 nga 31.03.2015, hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij dhe do të postohet në tabelën e shpalljeve të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Nr.01-1384/1
14.03.2019,Shkup

**Agjencia për shërbime
mediatike audio dhe audiovizuele
Kryetar i Këshillit,
Lazo Petrushevski, d.v.**